



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË

Nr. 6345 Prot.

Korçë, më 9 11 .2021

Lënda: Përcjellje dokumentacioni

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ASHK-TIRANË


Të nderuar!

Në bazë të aplikimeve me nr.23082 etj., dt.28.10.2021 etj., të znj. Erieta Gogo, ASHK-Drejtoria Vendore Korçë pasi shqyrtoi gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, në mbështetje të nenit 30 dhe 72 pika 2, të Ligjit nr 111/2018 “Për Kadastrën”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM 781, datë 07.10.2020 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, kreu procedurën për regjistrimin e pasurisë me nr. 5/272, vol.30, fq.142, zk.8561, Korçë, me sipërfaqe totale 360 m², nga e cila 360 m² truall dhe 94.5 m² ndërtesë, në emër të znj. Erieta Dhori Gogo. Bashkëngjitur shkresës po ju përcjellim Vendimin Nr.4, dt.29.10.2021, me anë të së cilit u regjistrua pasuria me të dhënat e mësipërme. *04.*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin !

DREJTORI

BESA SPAHO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË

VENDIM

Nr. 4, datë 29.10.2021

Sot në datën 29.10.2021, në mbështetje të nenit 30 dhe 72 pika 2, të Ligjit nr 111/2018 “Për Kadastrën”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM 781, datë 07.10.2020 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Korçë, mora në shqyrtim kërkesën nr. 9065 datë 03.07.2019, që i përket subjektit znj. Erieta Dhori Gogo.

Kërkues:

znj Erieta Dhori Gogo.

Me objekt:

Regjistrimin në favor znj Erieta Dhori Gogo, të pasurisë me nr. 5/272, volum 30, faqe 142, Zona Kadastrale 8561, Rruga “Guri Dolani” Qyteti i Korçës, në bazë të pikës 4 të nenit 30 të Ligjit nr 111/2018 “Për Kadastrën”, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 360 m², nga kjo sipërfaqe trualli 360 m² dhe ndërtesë 94.5 m², të ndodhur në qytetin e Korçës, Rruga “Guri Dolani”, me indeks harte KO-L-9, me shkallën 1:500. Pasuria e sipërcituar, gjatë regjistrimit fillestar sistematik të z.k. 8561, figuron e regjistruar sipas kartelës së pasurisë, në seksionin “C”, me shënimin “*P.P.V*” (Pronar i Pa Vërtetuar).

Pasi verifikova kompetencën lëndore dhe tokësore në zbatim të nenit 23 të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” konstatova se: Drejtoria Vendore e A.Sh.K.- Korçë, ka kompetencën lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.

Në vijim shqyrtova kërkesën e subjektit, dokumentacionin tekniko-ligjor bashkëlidhur saj, materialet shkresore të dorëzuara nga kërkuesi bashkëlidhur kërkesës së tij, ato të krijuara nga korespondenca me institucione të tjera dhe pasi kreu veprimet e nevojshme procedurale (si verifikime të dokumentacionit, verifikim në terren, konfirmime, etj.) dhe në zbatim të nenit 30 pika 4 të Ligjit nr 111/2018 “Për Kadastrën”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM 781, datë 07.10.2020 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”:

3

gjithë pronarët, pronat e të cilëve janë kufitare me njëra-tjetrën e të cilët kanë interes të ligjshëm për gjykim;

VKM 781, datë 07.10.2020 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, pika 3, ku përcaktohet se: “Agjencia Shtetërore e Kadastrës, këtu e ne vijim ASHK, vepron për përcaktimin e sipërfaqes dhe kufijve të pasurisë, në përputhje me përcaktimet e nenit 30, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, gjatë procedurave të regjistrimit fillestar, gjatë procedurave të përmirësimit të të dhënave të regjistrimit kadastral apo me kërkesë të subjekteve të interesuara”.

III. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE

Në datë 04.04.2019 znj. Erieta Dhori Gogo, përfaqësuar me prokurë nga z. Jani Stratobërdha, ka paraqitur kërkesë për regjistrim fillestar në bazë të nenit 25 “b” si pronare legjitime e pronës, kjo e vërtetuar nga dokumentat e paraqitur prej saj dhe ato që ndodhen pranë Drejtorisë Vendore të ASHK-së Korçë. Pronësinë e saj kërkuesja e bazon në dokumentacionin e mëposhtëm, e cila përbën dhe origjinën sipas rrjedhës kronologjike të pasurisë objekt shqyrtimi:

- **Transkriptimi nr. 281/6 datë 01.08.1933**, në rradhorët e pronësisë të qytetit rezulton e regjistruar kontrata e shit-blerjes me nr. 7982/5196 datë 31.07.1933 e hartuar para noterit z. Minella Noçka ku shitësi z. Dhori Pano Naumi (Pano). shiti gjysmën e një shtëpie banimi të ndodhur në lagjen e re të Korçës me kufij: Lindje: Rrugë, Jugu: Rrugë, Perëndim: Josif Spiro Dukan, Veriu: Vllazëria Mîsho, kundrejt shumë 2000 (dy mijë) franga ari, blerëses Znj. Kleoniqi Ilia Romba (Pano)

- **Vendimin e Gjykatës për pjestimin e një shtëpie dhe të sendeve të luajtshme Nr. 846 Vendimi datë 22.09.1977.** Në dispozitivin e këtij Vendimi është vendosur pjestimi I një shtëpie banimi të ndodhur në qytetin e Korçës, Lagjia 11, Rruga “Guri Dolani”, nr. 18, duke marrë paditësja Kleoniqi Pano pjesën “B” dhe e paditura Erjeta Gogo pjesën “A” të shtëpisë, pjesë këto të pasqyruara në skicat që shoqërojnë vendimin.

- **Dëshmi e Trashëgimisë Ligjore Nr. 104 Rep. Nr. 62 Kol. datë 25.01.2017** është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësit Dhori Pano Pano dhe Kleoniqi Ilia Pano nga të cilët trashëgon si trashëgimtare ligjore e vetme Erieta Dhori Gogo (Pano).

Përfundimisht nga dokumentacioni i përshkruar më sipër rezulton se Znj. Erieta Dhori Gogo (Pano) bëhet pronare e Vetme e një shtëpi banimi të ndodhur në lagjen nr. 11 rruga “Guri Dolani” dhe “Qemal Stafa” me kufij: Lindje: Trotuar, Perëndim: Aleksandër Duka, Veri Kristo Evangjeliu dhe Jugë: Trotuar.

Për këto arsye qytetari ka paraqitur kërkesë për kalimin nga sistemi hipotekor, në sistemin e ri të regjistrimit, shoqëruar më plan rievimi me topograf të licensuar për pasurinë e tij me nr. nr. 5/272, vol 30, faqe 142, z.k. 8561, Rruga “Guri Dolani”, Qyteti i Korçës, e regjistruar në kartelë më shënimin “PPV”, nga ku rezulton se sipërfaqja totale e pasurisë së tij është 360 m², nga kjo sipërfaqe trualli 360 m² dhe ndërtesë 94.5 m², si dhe deklaratën personale dhe deklaratat noteriale të kufitarëve, të cilat janë plotësuar sipas përcaktimeve të bëra në nenin

4

PER KETO ARSYE :

Bazuar në sa më sipër, dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 30, nenit 72 pika 2 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe VKM 781, datë 07.10.2020 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë,

VENDOSA :

- 1)- Miratimin e plotë të kërkesës së subjektit kërkues znj .Erieta Dhori Gogo për regjistrimin e pasurisë me nr. 5/272, vol 30, faqe 142, Zona Kadastrale 8561, Qyteti i Korçës Truall me sipërfaqe totale 360 m², nga e cila sipërfaqe trualli 360 m² dhe sipërfaqe ndërtese 94.5 m², Rruga “Guri Dolani” me indeks harte KO-L-9., në pronësi të Erieta Dhori Gogo.
- 2)- Një kopje e këtij vendimi i dërgohet kërkuesit.
- 3)- Kunder këtij vendimi, mund te bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
- 4)- Ky vendim afishohet në ambjentet e A.Sh.K.-Drejtoria Vendore Korçë dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të internetit të A.Sh.K –Tiranë.

Grupi i punës:

Jurist

Olsi Flamuraj



Inxhinier

Vladimir Kiço



**DREJTOR
BESA SPAHO**

